



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr. 03-328
17.10.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 14 nga Ligji për Media („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13 dhe 13/14), pikat 6 dhe 10 të Udhëzuesit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacioneve të arritshme për përdoruesit, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzuesit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3356/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin nr.02-3637/8 datë 17.10.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në vazhdimin e parë të seancës së 32-të mbajtur më 16.10.2023, miratoi si vijon:

Aktivendim
për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, për shkeljen e kryer të nenit 14 nga Ligji për Media (LM), të mënyrës që radiodifuzeri në kuadër të shërbimit të tij programor, transmetuar më 8 gusht 2023, në pjesë të programeve të transmetuara nuk ka publikuar të dhënat për impresium që është i detyruar t'i publikon në vendin e duhur për çdo përmbajtje në veçanti të shërbimit programor.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3356/1 datë 01.09.2023, që është pjesë përbërëse e këtij aktivendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktivendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LM.

3. Pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktivendim të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktivendimi, ka vepruar sipas aktivendimit.

4. Ky Aktivendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratim llogaritet dita e vërtetimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente të kryen mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara me nenet 6, 8, 14 dhe 15 nga LM.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – vërejtje publike në pajtim me Ligjin, në rastet kur është kryer shkelje (cënim) ose shkelje të dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29, paragrafi (2) nga LM, masat që Agjencia si trup rregullator kompetent mund t'i ndërmerr, dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu dhe në rast të shkeljes së dispozitave nga LM.

Sipas nenit 14 nga LM, botuesi i medias obligohet në vendin e duhur për çdo bartës të përmbajtjes në veçanti (p.sh kopje të medias së shtypit dhe emision televiziv) të siguron publikim të të dhënave në vijim: emërtim dhe adresë të selisë dhe redaksisë të botuesit të medias, emër të personit përgjegjës të botuesit

të medias, emër dhe mbiemër të redaktorit përgjegjës, gjegjësisht redaktorëve në pajtueshmëri me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emërtim dhe adresë të shtypshkronjës dhe datën e botimit ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të botimit, kur kemi të bëjmë me media të shtypit. Për radiodifuzerë detyrimet e mësipërme zbatohen në atë mënyrë që të dhënat publikohen në fillim dhe në fund të programeve audio/audiovizuale. Botuesi i medias është i obliguar që në vendin e duhur për çdo përmbajtje t'i publikon të dhënat në vijim: emër dhe mbiemër të autorit të fragmentit të publikuar, emër dhe mbiemër të personit, gjegjësisht të firmës bartës të të drejtës autoriale për përmbajtjet e publikuara, përveçse në mediat e shtypit dhe programeve në radio, datën e produksionit (muaj dhe viti) kur kemi të bëjmë me vepër audio/audiovizuale, origjina e veprës audio/audiovizuale, dhe derisa vepra është krijuar nga produksion i pavarur dhe informacion për produksionin, emrin e drejtuesit, gjegjësisht emër dhe mbiemër të personit që e ruan të mirën kulturore të përdorur ose vepër arkivore, gjegjësisht reproduksionin përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga ku është marrë fragmenti programor, vetëm nëse me marrëveshje të ndërsjelltë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për plotësimin e detyrimeve për impresium dhe informacione të arritshme për përdoruesit, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, në programet e tjera të prodhimit vendor, impresium publikohet kështu: që në shpicën lajmëruese dhe çlajmëruese publikohen të dhënat në vijim: emër dhe mbiemër të redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emër dhe mbiemër të redaktorit/autorit/prezantuesit të emisionit; emër dhe mbiemër të kan-autorëve, gjegjësisht të gjithë stafit realizues televiziv që marrin pjesë në tërësi të veprës audiovizuale; emërtim të subjektit që ka prodhuar programin (vetë radiodifuzeri, koproducentët, producentin e pavarur nga ku është porositur programi) dhe datën e produksionit (muaj dhe viti). Nëse është e nevojshme, duhet të publikohen dhe të dhëna për: emrin e personit juridik, gjegjësisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan të mirën e përdorur kulturore ose vepër arkivore, gjegjësisht reproduksionin e veprës dhe emrin e subjekti tjetër nga ku është marrë fragmenti i caktuar ose pjesë nga fragmenti, vetëm nëse me marrëveshje të ndërsjelltë nuk është rregulluar ndryshe.

Në pikën 10 nga Udhëzimi i cituar është përcaktuar se nëse transmeton program nga prodhim i huaj, televizioni duhet të transmeton shpicën origjinale.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për Çështje Programore, më 1 shtator 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, transmetuar më 8 gusht 2023, nga ku konstatoi shkelje të nenit 14 nga LM. Njëkohësisht, nga mbikëqyrja është konstatuar se në pjesë të programave të transmetuara më 8 gusht 2023, nuk janë publikuar të dhënat me të cilat identifikohen autorët që kanë marrë pjesë në përgatitjen e përmbajtjes audiovizuale, për bartësin e të drejtës autoriale, për redaktorin përgjegjës/redaktorë të programeve, për origjinën dhe për datën e produksionit të veprave audiovizuale, emrin e mediumit nga ku është ndërmarrë përmbajtja. Në kundërshtim me pikat 6 (impresium për program nga prodhim vendor) dhe 10 (impresium për program nga prodhim i huaj) nga Udhëzimi për plotësimin e detyrimeve për impresium dhe informacione të arritshme për përdoruesit, pa impresium janë transmetuar: TV Dnevnikot/Vesti të TV Zdravkin – programi në tërësi, vetëm në mënyrë grafike është paraqitur me lajmërim autentik dhe shpicë çlajmëruese të Televizionit, ndërsa përmbajtja paraqet një përmbledhje montazhi nga shtojca informative të bëra nga redaksitë e Radio Sloboda Evropa dhe të Gllasot na Amerika (lajme në gjuhën maqedonase); dhe Video lajm i shkurtër – i marrë nga Euronews, disa herë janë transmetuar fragmenete të ndara nga video lajme - „Pa koment“ (pa kontest të zgjeruar gazetaresk) për ngjarje vijuese nga Ukraina („Rregullimi i monumenti kombëtar në Kiev“) dhe nga Pakistani („Zheleznička nesreça“). Këto janë të dhëna që radiodifuzeri është i detyruar t'i transmeton në vendin e duhur për çdo përmbajtje të shërbimit programor.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar sipas datës, titullit të emisionit, periudha e transmetimit (fillimi dhe fundi) dhe përshkrim në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3356/1 datë 01.09.2023, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, më 06.09.2023, dërgoi Shkresë me nr ynë.ark.10-3356/2 datë 06.09.2023 me të cilën i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3356/1 datë 01.09.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkelje të kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga ana e radiodifuzerit më 11.09.2023. Në afatin e parashikuar, SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 16.09.2023, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim, konkludoi që SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles t'i shqipton masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 14 nga LM, pikat 6 dhe 10 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacion të arritshëm për përdoruesit, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-3356/1 datë 01.09.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3637/8 datë 17.10.2023, për konstatim të mos respektimit të dispozitave nga LM, përcaktuar në pikën 1. të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur me datë 16.10.2023,

miratoi Aktvendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJJP Veles, dhe e obligon që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të këtij Aktvendimi të harmonizon punën e vet me dispozitat nga LM. Pas mbarimit të afatit, përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-3356/1 datë 01.09.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi, radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.